REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 542/26 Dt. 18.11.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), Ligjit nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, nenit 5, 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ (QKR) nr. 06/22 për Themelimin dhe Funksionimin e Ekipit për Mbrojtjen e Fëmijës dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për formimin e Grupit Punues

1. Formohet dhe emërohet Grupi Punues për hartimin e Planit të Veprimit për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës për Komunën e Prizrenit për periudhën 2027-2029. Anëtarë të këtij Grupi Punues, emërohen:

   1.1. Fatmir Memaj .....drejtor i Drejtorisë Punës dhe Mirëqenies Sociale, i kryesuesit të ekipit,
   1.2. Bashkim Rakaj,.....udhëheqës i DPMD,
   1.3. Atila Arzuallxhiu, ...Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës,
   1.4. Fatlinda Ukaj .....Drejtoria e Shëndetësisë,
   1.5. Vetan Xhemaj, ...Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
   1.6. Lulzim Sulejmani,.....Drejtori e Ekonomisë dhe Financave,
   1.7. Trendelina Kastrati, ...Komiteti për Politikë dhe Financa,
   1.8. Fatmir Menekshe, ...Komiteti për Komunitete,
   1.9. Emine Gashi,.....zyrtare për mbrojtjen e fëmijë, Njësia për të Drejtat e Njeriut,
   1.10. Kumrije Bytyqi,..... Qendra për Punë Sociale,
   1.11. Muhamed Shala,..... Qendra për Punë Sociale,
   1.12. Osman Osmani,.....Novo Koncepti....Përfaqësues nga Shoqëria Civile,
   1.13. Elda Qylangji,..... përfaqësuese e fëmijëve apo e grupit të fëmijëve,
   1.14. Hajrim Çengaj,.....Kryetar i Këshillit të Prindërve,
   1.15. Naser Lajqi,.....ekspert i jashtëm nga Organizata Syri Vizion.

2. Detyrat e Grupit Punues të emëruar si në pikën 1 të këtij Vendimi është që në afat sa më të shkurtër kohor të hartoj Planin e Veprimit për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës për Komunën e Prizrenit për periudhën 2027-2029, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, dhe pas hartimit të drafti përkatës, të njëjtat ti procedohen organeve kompetente për shqyrtim dhe miratim.

3. Obligohet Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Grupi Punues për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale,
- Grupit Punues,
- Arkivës së Kryetarit.